



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA SUPREME – VRHOVNI SUD

GJS-2024-006

Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës – Fejzullah Rexhepi, bazuar në nenin 9 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 6 i Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga pala ankuese L.A., kundër vendimit të Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë, A. Sh-R. më 12.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

Hudhet si e pa lejuar, ankesa e palës ankuese L.A., e paraqitur kundër vendimit të Kryetares së Gjykatës Themelore të Prishtinë, AD/GJTHPR.nr.06/24, i datës 08.04.2024.

A r s y e t i m

Në këtë Gjykatë me 22 maj 2024, përmes Zyrës së Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, është pranuar ankesa e palës L.A., e parashtruar kundër vendimit të Kryetares së Gjykatës Themelore të Prishtinë, AD/GJTHPR.nr.06/24, të datës 08.04.2024 me të cilin është refuzuar ankesa e palës së lartcekur për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit R.G..

Kryetari i Gjykatës Supreme pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të cilat i janë bashkangjitur ankesës, vlerëson se:

- Ankesa nuk është e lejuar.

Nga shkresat e çështjes rezulton se parashtruesi ka ushtruar ankesë ndaj gjyqtarit R.G., - gjyqtar në Gjykatën Themelore, duke kërkuar iniciimin e procedurës disiplinore ndaj tij.

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, si autoritet kompetent për të vendosur lidhur me ankesën, konform dispozitës së nenit 9 par.1 nënpar.1.1 të Ligjit Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka vendosur përkitazi me ankesën e palës, me vendimin AD/GJTHPR.nr.06/24, të datës 08.04.2024, ku e ka refuzuar atë si të papabuar.

Ndaj vendimit të lartcekur në këtë gjykatë ka ushtruar ankesë pala L.A., me pretendimet e tij se ankesa e tij ndaj gjyqtarit R.G., është trajtuar me mos zbatim të dispozitave ligjore, zbatim të gabuar të ligjit, me mos respektim të parimit të pavarësisë dhe paanshmërisë ligjore, derisa

nga kjo Gjykatë ka kërkuar të anulohet vendimin, si dhe të shqiptohen masat më të rënda disiplinore ndaj Kryetares së Gjykatës.

Duke pas parasysh këtë gjendje të çështjes vlerësoj se ankesa në rastin konkret nuk është e lejuar për këto arsye:

Sipas Ligjit nr.06/L-057 “Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve” respektivisht nenit 9 par.1 të këtij ligji - secili person fizik dhe juridik mund të parashtrij ankesë ndaj një gjyqtari tek Autoriteti Kompetent apo tek Avokati i Popullit, i cili duhet që ankesën ta përcjell tek Autoriteti Kompetent. Po ashtu, sipas këtij ligji - nenit 9 par.6 të tij autoriteti kompetent shqyrton ankesën brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të ankesës dhe vepron në përputhje me nenin 12 par.2 (e fillon procedurën disiplinore kur vlerëson se ka bazë), përveç kur konstaton se ankesa është dukshëm joserioze, e pabazuar, nuk ka të bëjë me ndonjë shkelje disiplinore, ose është parashkruar. Kurse, edhe sipas Rregullores (05/2019) nenit 7 par.1 të kësaj Rregulloreje pas ndërmarrjes së veprimeve fillestare, Autoriteti Kompetent ankesën mund ta hudh, refuzon, ose të kërkojë nga Këshilli fillimin e hetimeve. Mirëpo, me asnjë dispozitë ligjore nuk parashihet se në rastet kur autoriteti kompetent e refuzon ankesën për inicim të procedurës disiplinore ankuesi mund të ushtrojë ankesë ndaj këtij vendimi.

Bazuar në këto rrethana, duke vlerësuar ankesën e parashtruar ndaj vendimit të Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë së bashku me shkresat e bashkëngjitura, vlerësoj se ankesa është e palejuar.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Fejzullah Rexhepi
Kryetar i Gjykatës Supreme

Kopje:

1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës,
2. Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë.
3. Palës ankuese,
4. Arkivit të Gjykatës Supreme.